

8 vjet **KEDS**

Alper Erbař
CEO

Gjatë kohës së shkurtër të operimeve tona në Kosovë, ne kemi kryer punën e munguar dekada me radhë, duke mundësuar që qindra-mijëra konsumatorë të kenë një jetë më të mirë nga investimet dhe vizioni ynë.

Ne sot, përmes përmirësimit të rrjetit, avancimit të sistemit dhe digjitalizimit, po ofrojmë shërbimet më kualitative me kostot më të ulëta për të rritur kualitetin e jetës për secilin qytetar të Kosovës.

Paralel me këto, ne tash e 8 vjet jemi të pakursyer në aktivitetet tona ndaj komunitetit, ashtu siç bën çdo kompani e përgjegjshme.

Të gjitha këto e bëjnë KEDS-in kompani moderne dhe të vendosur t'i aplikojë standardet më të larta të ndërmarrësisë.

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'A. D. C. D. E.' with a horizontal line underneath.

Ne jemi KEDS

Kompania Kosovare për Distribim të Energjisë Elektrike, ka ekskluzivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike në tërë territorin e Kosovës.

KEDS numëron afro 2000 punëtorë, të cilët janë të përkushtuar që t'i shërbejnë me profesionalizëm e integritet të lartë të gjithë qytetarëve të Kosovës, me fokusin e vetëm - për të siguruar zgjidhjet më të mira të energjisë për të gjithë konsumatorët.

KEDS bën shpërndarjen e energjisë elektrike deri te konsumatori i fundit, menaxhon dhe mirëmban asetet në terren. Në kuadër të KEDS janë të përfshira të gjitha linjat e energjisë elektrike të tensionit të mesëm, tensionit të ulët dhe trafostacionet përkatëse me stabilimentet përcjellëse.





VIZIONI

Përmes investimeve të vazhdueshme synojmë të rrisim kualitetin e jetesës për secilin qytetar të Republikës së Kosovës.

MISIONI

Ta ndriçojmë Kosovën me koston më të ulët të mundshme, me teknologjitë më bashkëkohore.

VLERAT TONA

Ofrojmë ekipe profesionale në shërbim të qytetarëve, siguri maksimale në punë dhe kontribut të pakursyer për komunitetin.

Punonjësit tanë përqafojnë një kulturë me përgjegjësi personale, që ka për bazë shërbimin ndaj qytetarëve, duke plotësuar kërkesat e tregut dhe duke siguruar një të ardhme të qëndrueshme në zinxhirin e sistemit elektroenergjetik të vendit tonë.



Afër konsumatorëve

Konsumatorët tanë janë pjesë shumë e rëndësishme e kompanisë. Ata na mundësojnë të jetësojmë vlerat tona, integritetin, shërbimet korrekte, profesionale dhe të sinqerta.

Përkushtimi individual i secilit punonjës dhe i kompanisë si tërësi, në mbështetjen dhe realizimin e kërkesave të konsumatorëve tanë, është baza e operimit dhe funksionimit të KEDS.



Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike bën shpërndarjen e energjisë elektrike në të gjithë vendin.

KEDS është i përkushtuar t'u ofrojë konsumatorëve shërbime korrekte, të sigurta dhe lehtë të qasshme për ta.

Duke respektuar ligjet në fuqi dhe duke përcaktuar objektiva për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve tona, ne po ruajmë dhe po kultivojmë vlerat dhe kujdesin ndaj konsumatorëve tanë. Në bashkëpunim me ekspertët tanë të kujdesit për konsumatorë, të gjitha kërkesat dhe ankesat e konsumatorëve trajtohen me kujdes dhe përgjegjësi të lartë. KEDS kujdeset me theks të veçantë që konsumatorët e rinj dhe ata ekzistues të gëzojnë të drejta dhe trajtime të paanshme.



Meqenëse konsumatorët komercial janë faktorë kyç në zhvillimin e vendit, KEDS përkushtohet të plotësojë kërkesat e tyre me prioritet.

Për shërbime më efikase, zyrat për Kujdes ndaj Konsumatorit kanë linjën e veçantë që i dedikohet kërkesave të konsumatorëve komercial në secilin rajon të Kosovës.

Për të gjithë konsumatorët cilët do qofshin ata, KEDS ka në dispozicion profesionistë të qasshëm për t'u konsultuar në çdo kohë.

Në anën tjetër platformat tona online, duke përfshirë rrjetet sociale dhe uebfaqen zyrtare, janë kanalet tona moderne të dizajnuara për të ndihmuar konsumatorët tanë për çdo çështje që ata kanë nevojë.



Për komunitetin

Jemi krenarë që ndriçojmë shtëpitë, shkollat, bizneset dhe lagjet e Kosovës. Së bashku, ne kemi ndriçuar edhe komunitetin tonë me programet edukative, donacionet dhe mbështetjet tjera të vazhdueshme në të mirën e shoqërisë.

Kompania jonë është ndërtuar mbi shtylla të forta dhe po vazhdon të zgjedhë materialin më të qëndrueshëm jo vetëm në fushën e energjetikës, por edhe në përkushtimin e vazhdueshëm për edukim, barazi gjinore dhe përmirësim të jetesës së komunitetit në përgjithësi. Kjo, sepse ne jemi të dedikuar të bëjmë ndryshime afatgjate në vendin ku ne punojmë dhe jetojmë çdo ditë.

Krahas ndriçimit të shtëpive tuaja, ne po ndërtojmë komunitetin duke e bërë jetën më të ndritshme për tash dhe për brezat e ardhshëm



Edukimi

KEDS Academy është program edukativ njëvjeçar i fokusuar në sektorin e energjisë elektrike. Ky program nën udhëheqjen e profesionistëve vendor dhe të huaj, ka për qëllim të aftësojë nxënësit dhe studentët kosovarë për tregun e punës. I ndarë në tri pjesë, në atë teorike, praktike dhe të internshipit, programi i mundëson pjesëmarrësve të përjetojnë ndjesinë e ambienteve të punës. Duke i dhënë atyre qasje në zgjidhjen e problemeve reale që ndodhin aty për aty. Deri më tani nga ky program janë certifikuar më shumë se 350 të rinj dhe shumica nga ta janë avancuar në karrierë, madje sot mbi 200 studentë janë të punësuar në KEDS.



Arti

KEDS është i vendosur të investojë në çfarëdo mënyre dhe në cilëndo sferë që komuniteti ynë ka nevojë vetëm e vetëm për të përmirësuar kualitetin e jetës të secilit banor të Kosovës. Për këtë arsye, KEDS së bashku me organizatën e artistëve Q'art tash e sa kohë po i jep ngjyrë lagjeve të ndryshme të Prishtinës, duke i dhënë jetë trafostacioneve të KEDS. Deri më tani janë transformuar më shumë se 20 trafostacione në vepra arti, me figura apo pikturime varësisht nga inspirimi i artistëve. Duke mbështetur fushën e artit në vend, ne jo vetëm që po i japim pamje urbane dhe moderne vendbanimeve, por edhe po mbështesim kauza të rëndësishme dhe aktuale në gjithë botën.



Barazia Gjinore

Ne e konsiderojmë barazinë gjinore si aspekt të rëndësishëm të funksionimit të kompanisë. Për këtë arsye, në fund të vitit 2019 KEDS ka nënshkruar 7 parimet për Fuqizimin e Gruas të themeluara nga UN Global Compact dhe UN Women. Për t'i zbatuar këto parime udhërrëfyese edhe në praktikë, kompania ka hartuar projektin për barazi gjinore me emrin "WomEn", që do të thotë "Women in Energy". Qëllimi i këtij projekti është që të promovojë, të fuqizojë dhe të përkrahë gratë brenda kompanisë, sektorit energjetik, si dhe në komunitet. KEDS do të vazhdojë të bëjë ndryshime pozitive sa i përket barazisë gjinore dhe fuqizimit të gruas sot dhe në të ardhmen.



Mbi 100.000

shtylla të vendosura/zëvendësuara

8 vite në perspektivë



Rreth 200.000 mijë

konsumatorë të rinj në rrjet



Mbi 167 milionë

euro investime në rrjet



Mbi 14 milionë

metër kablllo të reja nëntokësore dhe ajrore



69 NËNSTACIONE

të tensionit të mesëm
janë digjitalizuar

432,840

njehsorë digjital

122,175

njehsorë mekanikë

72,926

njehsorë të mençur



Bashkë për sigurinë

Ne si KEDS kemi siguruar për punonjësit pajisjet e nevojshme, si dhe ofruar mbështetjen e duhur për të qenë të sigurt, efektiv dhe për të arritur performancë të lartë në punë.

Inkurajimi i punës ekipore dhe ofrimi i një mjedisi pune të sigurt, ku gjithsecili çmohet dhe vlerësohet për punën që bën, është ajo që na përfaqëson rrënjësisht.

Siguria në punë mbetet prioritet i strategjisë së kompanisë. Kjo sepse ne jemi të vetëdijshëm sa është e rëndësishme të kemi punonjës që janë të përgatitur paraprakisht për të shmangur aksidentet në punë dhe për t'u përgjigjur efektivisht dhe shpejt në situata rreziku.

Si rezultat i punës ekipore, përkushtimit dhe angazhimit të punonjësve tanë, numri i aksidenteve në vendin e punës për tri vitet e fundit (2017-2020) është ulur për 56%.



Për të ngritur në nivele edhe më të larta çështjen e sigurisë, në vitin 2018 KEDS ka themeluar Qendrën e Trajnimeve.

E pajisur me të gjitha simulimet e situatave që punëtorët hasin gjatë punës reale në terren, kjo qendër deri më tani ka trajnuar 2285 punonjës në module të ndryshme varësisht nga profilizimi i tyre në kompani.

Duke ofruar praktikat më të mira sa i përket anës së sigurisë në punë, kjo qendër mundëson punonjësit e KEDS të fitojnë njohuritë më se të domosdoshme për kryerjen e punëve me siguri dhe sukses.

Trajnimet azhurnohen në bazë të dhënave të marra nga departamentet e kompanisë, pra duke iu përshtatur nevojave dhe situatave të punës që kërkojnë trajnim.



Qendra e Trajnimit zhvillon modulën e përbashkët të sigurisë dhe shëndetit për secilin punëtor të terrenit.

Përpos modulit të sigurisë, përpjekjet e qendrës fokusohen edhe në zhvillimin e aftësive, si dhe njohurive më të avancuara në fushën e inxhinierisë elektrike.

Është paraparë që në planin afatmesëm Qendra e Trajnimit të jetë e hapur edhe në aftësimin e të rinjve të Kosovës, me theks në elektroenergjetikë, për t'i ndihmuar ata t'i zhvillojnë aftësitë konkurruese në tregun e punës.

Përderisa siguria fillon në Qendrën e Trajnimeve përfundon në qëndrueshmërinë e rrjetit elektrik.



Punëtorë dhe vullnetarë

KEDS beson që kontributi vullnetar nuk është thjesht një aktivitet shoqëror, por mbi të gjitha është përpjekje për të ndryshuar dhe transformuar shoqërinë.

Zhvillimin dhe kultivimin e një kulture të vullnetarizmit brenda kompanisë KEDS e ka nisur qysh nga fillet e operimeve tona në Kosovë. Përmes programeve dhe projekteve të veçanta, përpos kontributit të kompanisë, punonjësit angazhohen individualisht në aktivitete vullnetare.

E gjithë kjo realizohet duke u bazuar në objektivat, misionin dhe kulturën e kompanisë për të ndihmuar komunitetin dhe për të shtyrë punonjësit që të krijojnë eksperiencë të veçanta humanitare në komunitet.



KEDS është vazhdimisht pjesë e aktiviteteve në mbështetje të kauzave të ndryshme, duke ofruar ndihmë profesionale në fushën e energjetikës të grupet e caktuara.

Për më tepër angazhimi i punonjësve të KEDS përfshinë edhe kontributin për ambientin, shkollat, bibliotekat, artin dhe kulturën në vend. Vullnetarisht, me nismën e kompanisë punonjësit e KEDS kanë kontribuar në krijimin e katër bibliotekave. Deri më sot janë dhuruar afro 1300 libra falas të grumbulluara nga punëtorët e KEDS, ndërsa kanë përfituar qindra nxënës.

Punëtorët e KEDS së bashku me studentët e KEDS Academy kanë zhvilluar disa aksione vullnetare për efikasitet të energjisë elektrike, duke publikuar informata dhe duke i shpërndarë ato të konsumatorët derë më derë apo edhe duke mbajtur ligjërata për studentët e universiteteve publike në vend.



Në aksionet vullnetare të suksesshme KEDS njih edhe angazhimin e një numri të madh të punëtorëve për dhurimin e gjakut. Po ashtu edhe aksionin për Ditën e Tokës me gjelbërimin e kopshteve të 4 shkollave.


Ky angazhim ndikon në gjenerimin dhe krijimin e marrëdhënieve dhe raporteve më të mira për punëtorët tanë mes veti, brenda kompanisë dhe në komunitet.

Aktivitet tjetër vullnetar është edhe angazhimi i KEDS me organizatën Down Syndrome Kosova, për ngjyrosjen e një trafoje në qytet, si aktivitet socializimi më fëmijët e përfaqësuar nga kjo organizatë. Këto dhe shumë ngjarje të tjera të mëdha dhe domethënëse tashmë janë pjesë e qenësishme e punës së kompanisë. Me vullnetin e tyre të lirë, punonjësit kanë ofruar dhe vazhdojnë të ofrojnë kontributin e tyre personal për atë kolektiv.



Operime inovative

Ne, sot jemi krenarë për punën e realizuar në rrjet ndër vite. Përkushtimi ynë për të ofruar shërbime kualitative ka tejkaluar pritshmëritë e konsumatorëve tanë. Investimet e realizuara në automatizim të pajisjeve e digjitalizim të sistemeve na mundësojnë që komplet rrjetin ta kemi në dorë. Kjo është epoka digjitale e KEDS.



SCADA

Integrimi i sistemit më bashkohor SCADA për mbikëqyrjen e nënstacioneve elektrike nga distanca ka ndikuar drejtpërdrejt në menaxhim më efikas të rrjetit dhe në operimet tona ditore. Shfrytëzimi i teknologjisë moderne dhe integrimi i saj përbrenda rrjetit ka bërë që të zvogëlohet kohëzgjatja e prishjeve, të zvogëlohen humbjet teknike dhe jo-teknike dhe të rritet efikasiteti i fuqisë punëtore, duke reaguar më shpejt ndaj avarive në rrjet.



KOSOVANET

Çdo gjë që ndodhë në rrjetin distributiv transmetohet në databazën e KOSOVANET. Përmes këtij sistemi na mundësohet të kemi një pasqyrë të qartë të rrjetit distributiv në kohë reale. Kjo ka bërë që konsumatorët të përfitojnë jashtëzakonisht shumë, duke shkurtuar kohën e ndalesave, duke rritur reagimet për intervenime, saktësinë dhe efikasitetin. Kosovonet kontribuon në rrjedhshmërinë e punëve duke u bërë pjesë e pandashme e operimit të ekipeve të prishjeve dhe nivelit organizativ.



Hand Held Unit (HHU)

Dëshmia se prishja është marrë parasysh nga ekipet tona, evidentohet në aparatet e dorës HHU (Hand Held Unit), ku futen të dhënat dhe puna që është bërë nga ekipi në terren për rregullimin e defektit dhe eliminimin e problemit që është paraqitur nga konsumatori. HHU mundëson matjen e efikasitetit të ekipeve në rregullimin e prishjeve. Me këtë pajisje janë avancuar shërbimet e leximit/faturimit, duke kaluar nga metoda manuale në atë digjitale.



Smart Meters

T'i ofrojmë konsumatorit shërbime moderne dhe të duhura është prioritet i yni. Njehsorët e mençur janë jetësim i misionit të KEDS për të qenë sa më afër tyre në çdo kohë. Matja e saktë e konsumit të energjisë, leximi në kohë reale, kontrollimi i cilësisë së energjisë dhe zvogëlimi i kohës pa energji të konsumatorëve, janë disa nga benefitet e kësaj pajisje elektronike. Projekte të tilla inovative kanë ndikuar dukshëm në përmirësimin e shërbimeve për konsumatorët.



Energjia jonë për ju

Çdo gjë fillon me synimin tonë – të sigurojmë rrjet stabil, modern dhe të qëndrueshëm me koston me të ulët të mundshme.

Zotimet tona janë afatgjate. Ne punojmë tash duke menduar të ardhmen, investojmë sot që e nesërmja të jetë e ndriçuar për shoqërinë tonë, ekonominë e vendit dhe mjedisin ku jetojmë.

Në këtë rrugëtim, KEDS ka partner qytetarin, si dhe devotshmërinë dhe përkushtimin e punës të secilit punonjës.



Sepse jemi të vendosur ...

Energjia elektrike është e nevojshme 24/7, dhe ne jemi në gatishmëri t'i shërbejmë konsumatorëve 24/7.

Duke përdorur të gjitha kapacitetet tona njerëzore dhe pajisjet më të sofistikuara, ne jemi gjithmonë aty ku është edhe konsumatori.

Krahas investimeve në rrjet, ne investojmë edhe në raportet tona me komunitetin, dëgjojmë zërin e çdo konsumatori dhe i përgjigjemi asaj/atij me devotshmëri të lartë.

Këtë e kemi bërë nga dita e parë dhe do të vazhdojmë kështu edhe në të ardhmen.



dhe kemi energjinë

Nga dita e parë e operimeve tona, kemi vendosur ndryshimin.

Ndryshimin në rrjet, ndryshimin në raport me konsumatorin, ndryshimin me punëtorët tonë, partnerët tonë, ndryshimin të secili nga ne.

Çdo ndryshim i yni është shndërruar në zhvillim. Çdo sfidë në energji. Ky zhvillim dhe kjo energji solli suksese.

Çdo sukses po sjellë motiv për të vazhduar punën tutje.

Motivi ynë për të vazhduar tutje...

8 vjet janë pak në numra, por veprat që mund të kryhen gjatë këtyre viteve mund të jenë të shumta.

KEDS gjatë këtyre 8 viteve ka bërë ndryshime të mëdha, që kanë përmirësuar dukshëm infrastrukturën energjetike, duke siguruar stabilitet në furnizim të konsumatorëve me energji elektrike.

Tanimë bazat e një infrastrukture moderne energjetike i kemi vendosur, por nuk mjaftohemi me kaq. Synim i yni është që çdo pajisje e vjetër të zëvendësohet me një të re, ashtu që edhe konsumatori i fundit ta ndjejë ndryshimin.

Çdo ditë do të shohim alternativa të reja dhe moderne, në hap me kohën dhe zhvillimet botërore, ndryshimet nuk do të mbarojnë asnjëherë, sepse energjia elektrike është nevojë thelbësore, dhe ne do të jemi përherë aty ku kërkohet që të jemi, sepse gjithmonë punojmë dhe progresojmë shumë për të fituar besimin e konsumatorëve.

